



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

Nr. 1456/Prot.
12

Patos, më 04/10/21 2022

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot në datë 01.07.2022 ora 11:00, në ambientet e Njesisë Administrative Ruzhdie Fshati Gjinoqarë, zhvillohet dëgjesa publike me temë: **Diskutim për Lidhjen e kontratës së qirasë ndërmjet Bashkisë Patos dhe O.S.T sh.a” Përdorim të fondit pyjor kullor në administrim të Bashkisë Patos në funksion të forcimit dhe zgjerimit të linjës ekzistuese 220kV Fier”**

Pjesëmarrës në këtë dëgjese publike:

1. Sekretari i Këshillit
2. Kryetar të fshatrave të Njesisë Ruzhdie
3. Përfaqësues të OST sh.a Tiranë
4. Banorë të zonës
5. Përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe K.V.R-së
6. Koordinator i Konsultimit Publik

Takimi hapet nga Sekretari i Këshillit Bashkiak z. Balil Balili

Balil Balili – – të nderuar pjesëmarrës në radhë të parë dua t’ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë dëgjese publike lidhur mbi diskutimin për Lidhjen e kontratës së qirasë ndërmjet Bashkisë Patos dhe O.S.T sh.a”. për cdo paqartëi Drejtori i Bujqësisë do të na sqarojë , fjala është për ju.

Orges Gollosi- bazuar në shkresën me nr. 551 prot datë 26.01.2022 të Oeratorit të Sistemit të Transpetimit për marrjen në përdorim dhe heqjen nga fondi pyjor kullor që preken nga zbatimi i projektit për ndërtimin e linjës 400kv Shqipëri Maqedoni e Veriut ne si Drejtori e Bujqësisë në zbatim të këtij projekti kemi kërkuar dhe më pas është miratuar në Këshillin e Bashkisë për heqjen nga fondi kullor të sipërfaqes prej 921 m2, kjo e pasqyruar në VKB-në nr.23 datë 27.04.2022, kjo sipërfaqje do të shërbejë për instalimin e shtyllave në funksion të projektit. Gjithashtu gjurma e zgjerimit të linjës do të shtrihet në një gjatësi prej 1644 m-l me një trashe 50m, ku kjo sipërfaqje do të merret në përdorim nga operatori me afat 1 vjeçar për zhvillimin e punimeve. Për lidhjen e kontratës së qirasë midis Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe

Bashkisë Patos ligji i pushteti vendor 139/2015 por edhe rregullores se Këshillit për konsultimet publike, na detyron ne të realizojmë seanca dëgjimore për marrjen e mendimit të komuniteti që ky projekt prek nëse duhet të bëjmë një hap përpara për lidhjen e kontratës që padiskutim do të kërkojë miratim në Këshillin Bashkiak. Në mbështetje të raportit teknik të hartuar nga ana jonë mbi sipërfaqjen që preket nga zbatimi i projektit dua të theksoj se preken edhe prona publike në administrim të Bashkisë Patos por edhe prona private. Lidhur mbi sipërfaqen e cila është pronë e bashkisë ne jemi të qartë. Nuk e di nëse qytetarët janë të qartë mbi zbatimin e këtij, pasi preket edhe prona private dhe padiskutim që ju jeni më tepër të interesuar. Këtu me ne janë edhe përfaqësuesit e OST sh.a të cilët për çdo paqartësi tuajën do tju sqarojnë.

Agim Mesuti – ky projekt a ka ndikim mjedisor pasi zona ku kalon projekti prek fshatra të cilët kanë kurorën e gjelbërt të Njësisë Ruzhdië?

Arzika Preci - OST-ja është një kompani që operon në fushën e sektorit të energjisë elektrike dhe qëllimi jonë është garantimi dhe furnizimi i qëndrueshëm dhe i sigurt me energji elektrike të konsumatorit, sigurimin e shërbimit që ne ofrojmë po padyshim edhe mbrojtjen e mjedisit. Me pak fjalë ne operojmë me trasmetimin 400 kv dhe në praktikën e punës sonë si OST është edhe zbatimi i ligjit për mbrojtjen e mjedisit. Drejtoria e Mjedisit ku unë punoj ushtron presion të vazhdueshëm për të mos shkelur trasene. Përpara fillimit të projektit ne do të mundohemi të bëjmë dëmshpërblimin e cdo banori që preket nga ky projekt dhe vlera e dëmshpërblimit bëhet në bazë të ligjit dhe përcaktimit të tokës.

Dylber Laci - jam dakort me ato që thatë por shteti vërtet ka dhënë tokën por nuk ka të përcaktuar atë se çfarë unë mbjell pasi toka mund të jetë arë dhe është mbjellë ullishte dhe mendoj se dëmshpërblimi nuk duhet të jetë i njëjtë por duhet të saktësohet kjo pjesë pasi investimi nga fermeri në një rast të tillë mund të jetë më i lartë.

Arzika Preci – ne kemi tetë vjetë që ushtrojmë këtë funksion dhe ndaj bashkive ne paguajm taksën, lidhur mbi tokat private ne jemi në fazën e parë të tij dhe padyshim që fermeri do të dëmshpërblehet nga operatori nëse toka e tij preket nga projekti

Dylber Laci – problemi është se kategoria e tokës është e përcaktuar me VKM

Agim Mesuti – unë mendoj që Bashkia duhet të nxjerrë vlerën reale të tokës kjo në bazë të investimit që ka bërë fermeri.

Sako Myftari – në cilësinë e Kryetarit të fshatit me se mund tju ndihmojmë?

Agim Mesuti – përcaktimi i dëmshpërblimit do të jetë vetëm për gjurmën ku do të kalojë projekti me qëllim që të punojë më fermerët që cënohen.

Arzika Preci – ne si kompani në historikun e punës sonë nuk kemi patur ankesa lidhur mbi korrektësinë e dëmshpërblimit.

Balil Balili – çfarë sipërfaqe zë ky projekt?

Orges Gollosi – 921 m2 është sipërfaqja që do të shërbejë për instalimin e shtyllave si dhe 1644 m-l me një trashë prej 50 m do të jetë pjesa e kalimit të gjurmës së zgjerimit të linjës dhe nga ana e Bashkisë është vënë i gjithë dokumentacioni i kërkuar në dispozicion për këtë projekt.

Xhemil Begaj – lidhr mbi dëmshpërblimet ka të përcaktuar tarifat dhe ju si kompani na e keni vënë vonë në dispozicion bazën ligjore

Arzika Preci - unë besoj se kam qenë shumë bashkëpunuese jo vetëm me ju por me të pesëmbëdhjetë Bashkitë.

Xhemil Begaj – ai ligj na është vënë vonë në dispozicion me qëllim konsultimin me zyrën juridike nga ana jonë.

Arzika Preci – padiskutim që ne jemi të hapur për bashkëpunim dhe edhe pas këtij takimi mund të ulemi dhe të diskutojmë për cdo paqartësi që ju mund të keni.

Xhemil Begaj – disa toka nga ana e Bashkisë janë dhënë me qira, si mendoni se do të veprohet në një rast të tillë pasi pronari është Bashkia?

Arzika Preci – do të trajtohen njëjloj si pronarët privatë.

Agim Mesuti – padyshim që kjo është faza e parë e projektit dhe mendoj se ne do të ulemi përsëri për të trajtuar cdo problem që mund të na dali gjatë rrugë.

Balil Balili – padyshim që bashkëpunimi është i rëndësishëm, nëse ka ndonjë pyetje apo paqartësi kundrejt operatorit

Myftar Soraj – ne nuk jemi në kundërshtim të projektit por ajo që unë kërkoj jo vetëm për fermerët e fshatit Siqecë por për të gjithë atë fermerë që preken nga projekti të bëhet dëmshpërblimi i drejtë dhe në favor të fermerit.

Arzika Preci – padiskutim që për cdo fermer i cili do të preket nga projekti do të ketë edhe dëmshpërblimin por kjo e përcaktuar në bazë të ligjeve

Balil Balili – ndonjë pyetje tjetër? Mqse jo atëherë ky takim konsiderohet i mbyllur.

Konceptoi:

Koordinator Konsultimin Publik

Suzana Hysenaj

Sekretar Këshilli

Balil Balili



Ruzhdie me 01.07.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

LISTË-PREZENCË MBI DISKUTIMIN PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË PËR:

**“ PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KULLOSOR NË ADMINISTRIM TË BASHKISË PATOS NË FUNKSION TË FORCIMIT
DHE ZGJERIMIT TË LINJËS EKZISTUESE 220 KV FIER”**

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia/ Qyteti/ Fshati	Pozicioni/ Profesioni	Nr. Kontakti	Firma
1	Agim	Masuti	Thasë/Ruzhdie	Administratori	0682036282	
2	Orpes	Golloshi	Patos	Dr. Bujqësi	0693654661	
3	Meri	Beqaj	Patos	Sp. pyjore	0676291050	
4	Ermir	Pajaj	Patos	Grupi të rinjve të qytetit	0685571424	
5	Mustehak	Ripaj	Patos	Grupi të rinjve të qytetit	0698192485	
6	Alfred	Gremi	Patos	SP. Mjedisit	0694750159	
7	Alizaura	Gropa	Patos	Sp. Statistik SP. Rinise	0699490612	
8	Anisa	Beluli	Zharrez	Grupi të rinjve të qytetit	0693730114	
9	Veip	Amberaj	Patos	GRUPI të Rinjve	0693072997	
10	Dylber	Lajç	Ruzhdie	Grupi të Rinjve	0692123510	
11	Jakso	Ngjollari	Ruzhdie	Grupi të Rinjve	0699781493	
12	Imra	Kongli	Patos	Inj. Gjeologje	0692189725	
13						

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale”, Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore” I të dhënave personale, të mbledhura për çfarëdo qëllimi, mund të përpunohen më tej vetëm për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ.. Përpunimi i të dhënave personale lejohen të përdoren vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike. Përfshihet nga zbatimimi i neneve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes



Ruzhdie me 01.07.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

LISTË-PREZENCË MBI DISKUTIMIN PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË PËR:

**“ PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KULLOSOR NË ADMINISTRIM TË BASHKISË PATOS NË FUNKSION TË FORCIMIT
DHE ZGJERIMIT TË LINJËS EKZISTUESE 220 KV FIER ”**

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia/ Qyteti/ Fshati	Pozicioni/ Profesion	Nr. Kontakti	Firma
1	Pupyltar	SORRAJ	Ruzhdie	Cryetar Pzloti	0682453149	Bun
2	Arman	Prezi	DST. n.a.	P. Medarit	0689011620	ES
3	Ethna	Imameri	DST gha.	Secretari Mialist	0692748558	ES
4	Enil	Balili	Patos	zek. Këshilli	0697489901	ES
5	Suzana	Hysenaj	Patos	Koond. Konsertimi	0694881460	ES
6	Shekiper	Beqiri	Patos	Secretari Përkohor	0688065843	ES
7	Jreisi	Xhelaj	Patos	Sp. Integrimi Europian	0694770444	ES
8						
9						
10						
11						
12						
13						

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale”, Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore” I të dhënave personale, të mbledhura për çfarëdoq qëllimi, mund të përpunohen më tej vetëm për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose